



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201601652/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen e aktit për konstatimin e pavlefshmërisë së pjeshme absolute të aktit administrativ, Njoftimit nr.5140, datë 05.12.2012, të Entit Kombëtar të Banesave.*

Drejtuar : **Znj Doris Andoni**
Drejtoreshë e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave.

TIRANË

Për dijeni : **Eglantina Gjermeni**
Ministre e Ministrisë së Zhvillimit Urban

TIRANË

V.S.
Adresa:

TIRANË

E nderuar znj Drejtoresh e Përgjithshme!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasës V.S, në të cilën prezantohet shqetësimi i nxjerrjes prej organit që ju përfaqësoni i aktit administrativ, Njoftimit nr.5140/1 Prot, datë 05.12.2012, i cili cënon ankuesen në posedimin e qetë të banesës të ndodhur në Lagjen "Vojo Kushi", Rruga "M.Fortuzi", pjesë përbërëse e pasurisë së njohur dhe kthyer në natyrë sipas Vendimit nr. 565, datë 16.05.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Rajoni Nr.3, pranë Bashkisë së Qytetit, Tiranë, H., R, M e B.Ç, me objekt midis të tjerave:

"Të njoh ish pronarët H., R, M e B. Ç, në bazë të nenit 1 të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993, mbi pronën e tyre të përbërë prej shtëpive të ndodhura në Lagjen "Vojo Kushi", me hyrje nga Rruga "M.Fortuzi", duke kthyer e kompesuar se vijon;

1.a Një shtëpi që ndodhet në Lagjen "Vojo Kushi", me hyrje nga Rruga "M.Fortuzi", përbërë nga tre dollmaile, një sallon, një gjelltoe e veçuar, barrakë e

aksesorë, e kthyer në shtëpi banimi dhe oborr, siç paraqitet në genplan, dhe në bazë të nenit 4 të Ligjit 7698, i kthehet pronarëve H., R, M e B Ç”...

Nxjerrja e aktit administrativ, Njoftimit nr.5140/1 Prot, datë 05.12.2012, prej Entit Kombëtar të Banesave, rezulton të jetë kryer mbështetur në Aktin normativ, të Këshillit të Ministrave, nr.03, datë 01.03.2012, *“Për lirimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat e ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”*, miratuar me ligjin nr.82/2012, datë 13.09.2012, *“Për miratimin e Aktit normative, me fuqin e ligjit nr.3, datë 01.03.2012, “Për lirimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat e ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”*.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankueses, rezulton se, Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 05, datë 28.03.2000, ka vendosur midis të tjerave, për ; *“... anulimin pjesërisht të Vendimit nr.565, datë 16.05.1996, pika 1/a, vetëm për pjesën e barrakës dhe aksesorëve të kthyer në shtëpi banimi dhe oborrin e saj”*. Arritja në vendimarrjen si më sipërcituar, është kryer prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, referuar faktit se ;

“Në bazë të rregjistrimit hipotekor nr.352, datë 30.06.1955, paditësit të kundërpaditur, rezulton se i është shtetëzuar, për shkak të detyrimeve të papaguara, banesa me nr.14, në Rrugën “M.Fortuzi”, me vendimin e ish K.P. të Rrethit, Tiranë, me nr.20/1, datë 31.01.1974. Prona si më sipër e përcaktuar në këtë titull pronësie përbëhet nga tre oda “dollmalie”, një sallon, një gjelltoe e veçuar, oborr e aksesore, me kufizime të përcaktuara me këtë akt pronësie dhe i është kthyer ish pronarit sipas pikës 1/a të vendimit të sipërcituar. Kjo banesë që mban nr.14, sipas titullit të pronësisë nuk është privatizuar. Duhet theksuar se në aktin original të pronësisë nuk figuron e rregjistruar shtëpia e të paditurës kundërpaditëse me truallin përkatës, që e ka të rregjistruar, për të cilën gabimisht K.K.K. Pronave shprehet se ky truall figuron i lirë në një kohë që ai figuron i zënë me shtëpi banimi dhe oborr funksional”.

Përpos situatës të konstatuar nga Gjykata e Apelit, Tiranë, gjatë gjykimit të çështjes, dhe shprehjes së saj me Vendimin nr.05, datë 28.03.2000, vlerësojmë se, nxjerrja e aktit administrativ, Njoftimit nr.5140/1 Prot, datë 05.12.2012, prej Entit Kombëtar të Banesave, vjen në kundërshtim me vendimin gjyqësor në fjalë si dhe parashikimet e kryera në Aktin normativ, me fuqin e ligjit, nr.03, datë 01.03.2012, *“Për lirimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat e ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”*. Në kuptim dhe zbatim të ligjit të asaj kohe, nr.8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, neni 115 e vijues, akti administrativ, Njoftimi nr.5140/1 Prot, datë 05.12.2012, i Entit Kombëtar të Banesave, klasifikohet absolutisht i pavlefshëm përse i përket, pjesës së pasurisë : *“...barrakë e aksesore, e kthyer në shtëpi banimi e oborr”*, të njohur dhe kthyer në natyrë sipas Vendimit nr. 565, datë 16.05.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Rajoni nr.3, pranë Bashkisë së Qytetit, Tiranë, H., R, M e B. Ç, e cila do të duhet t’u dorëzohet këtyre subjekteve. Në kushtet kur ankuesja V. S shprehet se ka në posedim ambjent banim, pjesë përbërëse e pasurisë së hequr nga pronësia ish-pronarëve, sipas Vendimit nr. 05, datë 28.03.2000, të Gjykatës së Apelit, Tiranë, shtron nevojën e marrjes së masave të menjëhershme nga ana juaj znj.Drejtoresh e Përgjithshme, për nxjerrjen e aktit administrative sipas të cilit të deklarohet absolutisht i pavlefshëm Njoftimi nr.5140/1 Prot, datë 05.12.2012, i EKB, lidhur me detyrimin e lirimit të pasurisë *“...barrakë e aksesore, e kthyer në shtëpi*

banimi e oborr”, e cila sikurse shprehet ankuesja, posedohet prej saj. Gjithashtu, marrja e masave të menjëhershme për nxjerrjen e aktit administrative për konstatimin e pavlefshmërisë së pjeshme absolute të aktit administrativ, Njoftimit nr.5140/1, datë 05.12.2012, të Entit Kombëtar të Banesave, kushtëzohet dhe nga fakti se Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Privat është duke kryer veprime përmbartimore në ngarkim të V. S, për ekzekutimin e detyrueshëm të aktit administrativ, Njoftimit nr.5140/1 Prot, datë 05.12.2012, të EKB, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr. 11705 Akti, datë 17.12.2012, dhe se ankuesja është invalide.

Në kushtet kur akti administrativ, Njoftimit nr.5140/1, datë 05.12.2012, i nxjerrë nga ana e organit që ju përfaqësonij, nuk prodhon asnjë pasojë ligjore lidhur me pasurinë e hequr nga pronësia subjekteve bashkëpronarë, sipas Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr.05, datë 28.03.2000, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Tiranë, vlerësojmë të nevojshme e të domosdoshme, kryerjen e procedurës për konstatimin pjesërisht absolutisht të pavlefshme të aktit administrativ, Njoftimit nr.5140/1 Prot, datë 05.12.2012, të EKB, konform parashikimeve të nenit 111, 108/a/I të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”*.

Akti administrativ, Njoftimi nr.5140/1 Prot, datë 05.12.2012, të EKB, vlerësojmë se ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Funksionimi i organit që ju përfaqësoni në nxjerrjen e aktit administrativ, Njoftimi nr.5140/1 Prot, datë 05.12.2012, nuk ka ardhur në respekt të parimit të ligjshmërisë, parimit të mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave private, sikurse parashikuar në nenin 9 dhe 10 të Ligjit të kohës nr.8485, datë 12.05.1999(Kodi i Procedurës Administrative), të detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankueses në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, i cili parashikon se : *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDIJMË

Marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen e aktit për konstatimin e pavlefshmërisë së pjeshme absolute të aktit administrativ, Njoftimit nr.5140/1, datë 05.12.2012, të Entit Kombëtar të Banesave.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Kopje të Vendimit nr. 565, datë 16.05.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Rajoni nr.3, pranë Bashkisë së Qytetit Tiranë.

Kopje të Vendimit nr. 05, datë 28.03.2000, të Gjykata e Apelit, Tiranë.

Kopje të shkresës nr.4/1 Prot, datë 07.01.2013, të Arkivit Shtetëror Vendor, Tiranë.

Kopje të Vendimit nr.20/1, datë 31.01.1974, të ish K.P. të Rrethit, Tiranë, së bashku me listën e personave debitorve.

Kopje të Relacionit datë 22.12.1973, të mbajtur prej Shefit të Seksionit Komunal dhe përfaqësuesit të Komiteit Ekzekutiv të K.P.Rrethit, Tiranë, së bashku me listën e personave debitor.

Kopje të Vendimit nr. 11705 Akti, datë 17.12.2012, të Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Kopje të Autorizimit datë 04.04.1951 të K.E.Q, Seksioni Strehimit, Tiranë.

Kopje të Librezës së Qiras me nr.937, të lidhur midis Drejtoria nr.3 e Qytetit , Tiranë dhe të ndjerit S. S (babai i ankueses).

Kopje të shkresës nr.367 Prot, datë 25.02.2016, të Përmbaruesit Gjyqësor Privat, Erion Llalla.

Kopje të shkresës nr.415/2 Prot, datë 27.05.2013, të Përmbaruesit Gjyqësor Privat, Baftjar Nela.

Fragmet harte Viti 1956-1963, Shk.1;500, për pasuritë e paluajtshme të evidentuara në Rrugën e “Barrikadave”, lëshuar prej Arkivit, Tiranë.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**